

INA ARAPI

HADUMOD BUßMANN,**“Lexikon der Sprachwissenschaft” (Fjalor i gjuhësisë).**

Botimi i katërt, i kontrolluar dhe i plotësuar me të dhëna bibliografike në bashkëpunim me Hartmut Lauffer.

Shtëpia Botuese “Alfred Kröner”, Shtutgart 2008

“Fjalori i gjuhësisë” nga H. Bußmann është një vepër tashmë klasike në hapësirën gjermanishtfolëse për konceptet bazë që lidhen me shkencën e gjuhësisë. Ai i drejtohet një publiku të gjerë dhe synon të plotësojë jo vetëm nevojat imediate të studiuesve, por edhe të studentëve dhe të interesuarve të tjerë. Siç informon botuesja në parathënie, dhjetëvjeçarët e fundit tregu është pasuruar me një numër të konsiderueshëm manualesh, fjalorësh dhe enciklopedish, në gjuhën angleze dhe gjermane, të cilët përmbajnë shpjegime të hollësishme, por kanë edhe çmim të lartë. Duke shtuar se këto vepra voluminoze mund të gjenden e konsultohen pothuajse vetëm nëpër biblioteka, botuesja e sheh vlerën e veçantë të veprës së saj në faktin që ajo me përmasat, vetëm një vëllim, dhe çmimin që ka mund t’i shërbejë një publiku shumë të gjerë, çka është e vërtetë, sepse kjo vepër përdoret gjerësisht si nga specialistët ashtu dhe nga studentët e persona të tjerë.

Kjo vepër është shkruar në gjuhën gjermane, pra si fjalësi ashtu dhe shpjegimet përkatëset janë në gjermanisht, por në ato raste kur termat vendase nuk kanë arritur të imponohen, janë përfshirë termat origjinale në anglisht dhe shumë më rrallë në frëngjisht. Bëhet fjalë për terma e koncepte që janë brumosur nga gjuhëtarë anglishtfolës, të cilat edhe në gjermanisht përdoren zakonisht si në origjinal, p. sh. Code-Switching, Empty Category Principle, Generalized Phrase Structure Grammar, Raising, Script, Switch Reference (Bußmann 2008: VIII). Pranë termit në anglisht është vendosur në kllapa katrore edhe përkthimi ose termi i propozuar në gjermanisht. Po kështu shembujt janë marrë në radhë të parë nga gjermanishtja, por sipas rastit edhe nga anglishtja. Duke shpjeguar mënyrën e ndërtimit të zërave të ndryshëm botuesja sqaron se është vendosur një sistem referimi ndërmjet tyre për t’i lidhur ata me njëri-tjetrin. Kjo e forcon koherencën tematike, por nga ana tjetër bën që zërat të kenë formë dhe gjatësi të ndryshme duke filluar nga shpjegime të thukëta deri në paraqitje të hollësishme me karakter enciklopedik.

Botuesja na njofton gjithashtu në parathënie që duke u nisur nga ribotimi i tretë, rëndësi e madhe u është kushtuar zërave për gjuhët. Janë marrë parasysh përveç gjuhëve evropiane, aziatike dhe afrikane, të cilat u përkasin familjeve të njohura gjuhësore, edhe familje gjuhësore të rajoneve të tjera.

Siç e theksuam që në fillim ky është botimi i katërt i këtij fjalori. Për herë të parë ai është botuar në vitin 1983 duke pasur si autore të vetme H. Bußmann. Duke nisur nga botimi i dytë (1990), një botim krejtësisht i rishikuar, autorja bashkëpunoi me një kolektiv prej gjashtëmbëdhjetë specialistësh, të cilët e përpunuan rreth gjysmën e tekstit fillestar. Ky ribotim u përkthye edhe në anglisht (London 1996), në gjuhën kineze (Beijing/2003) e italisht (2007). Për botimin në anglisht teksti jo vetëm u përkthye, por edhe u përshtat e zgjerua. Gjatë këtij procesi ndihmuan bashkëpunëtorë të veçantë të botimit të dytë, po dhe shumë specialistë amerikanë me komentet e tyre kritike e plotësime derisa iu dha forma përfundimtare në Mynih. Teksti i botimit të katërt përputhet pothuaj tërësisht me atë të botimit të tretë (Bußmann 2008: IX).

Ajo çka na intereson neve direkt në këtë vepër është mënyra se si janë paraqitur zërat që lidhen me gjuhën shqipe. Në krahasim me botimin e parë, ku H. Bußmann ishte autore e vetme, zëri për gjuhën shqipe ka ndryshuar tërësisht. Ja si paraqitet ky zë në botimin e parë me autore H. Bußmann:

-Albanisch. Seit dem 16. Jh. schriftlich bezeugte indoeuropäische Sprache. Aufgrund zahlreicher Lehnwörter aus dem Lateinischen, Griechischen, Türkischen und Bulgarischen waren seine verwandtschaftlichen Beziehungen zu anderen ideur. Sprachen lange umstritten. / **Shqipja.** Gjuhë indoevropiane e dokumentuar me shkrim që prej shekullit XVI. Për shkak të huazimeve të shumta nga latinishtja, greqishtja, turqishtja dhe bullgarishtja, lidhjet e saj farefisnore me gjuhët e tjera indoevropiane kanë qenë për shumë kohë të diskutueshme (H. Bußmann 1983: 19).

Literatura që e shoqëron këtë zë është: E. P. Hamp [1966]: *The position of Albanian*. Në: H. Birnbaum/J. Puhvel (botues): *Ancient Indo-European dialects*. Berkeley, Los Angeles. Të njëjtët [1972]: *Albanian*. Në: Th. A. Sebeok (botues): *Current trends in linguistics*. Vëllimi IX. The Hague. L. Dodic/H. Krenn [1981]: *Albanisch*. Në: *Studia Linguistica*. Revue de Linguistique Générale et Comparée 10. Lund. Fq. 43-53.

Ndërsa në ribotimin e katërt lexojmë:

-Albanisch. Zweig des Indoeuropäischen, bestehend aus einer einzigen Sprache, die Staatssprache Albaniens ist und darüber hinaus in der Diaspora, z. B. in Gebieten nördlich von Albanien, in Griechenland und Italien gesprochen wird (ca. 5 Mio. SprecherInnen). Es gibt zwei Hauptdialekte, Ghegisch im Norden und Toskisch im Süden. Erste schriftliche Dokumente aus dem 15. Jh.- Spezifische Kennzeichen: Neben den üblichen Kategorien ideur. Sprachen wird am Nomen Definitheit bzw. Indefinitheit flexivisch ausgedrückt (vgl. *bukë* ›Brot‹, *buka* ›das Brot‹). Die Morphologie ist relativ komplex, vor allem im Verbalbereich (zwei Aspekte, acht Tempora, sechs Modi). Entwicklung von Objektkongruenz über proklitische Pronomina.

Zahlreiche Lehnwörter aus dem Lateinischen sowie Lehnwortbeziehungen mit anderen Balkan-Sprachen, vor allem dem Rumänischen, aber auch dem Griechischen und Türkischen. Wortstellung meist SVO, Adjektive werden nachgestellt. Als Überblick vgl. Demiraj & Esposito [2006] / **Shqipja**. Degë e indoevropianishtes, që përbëhet nga një gjuhë e vetme, e cila është gjuhë shtetërore e Shqipërisë dhe flitet përveç kësaj edhe në diasporë, p. sh. në territoret në veri të Shqipërisë, në Greqi dhe Itali (rreth 5 milionë folës dhe folëse). Ka dy dialekte kryesore, gegërishten në veri dhe toskërishten në jug. Dokumentat e para të shkruara i përkasin shekullit XV. Karakteristika specifike: krahas kategorive të zakonshme për gjuhët indoevropiane, shquarsia dhe joshquarsia e emrit shprehet me mjete flektive (krh. *bukë*, *buka*). Morfologjia është relativisht komplekse, sidomos në sistemin foljor (dy aspekte, tetë kohë, gjashtë mënyra). Zhvillim i kongruencës së kundrinave me anë të përemrave proklitike. Huazime të shumta nga latinishtja dhe marrëdhënie huazimi me gjuhë të tjera ballkanike, sidomos me rumanishten, por edhe me greqishten e turqishten. Rendi i fjalëve më së shpeshti SPO, mbiemrat pasvendosen. Për një vështrim të përgjithshëm krah. Demiraj & Esposito (2006) (Bußmann 2008: 24).

Pra, vihet re një përpunim tërësor i këtij zëri që ka ardhur jo vetëm si pasojë e ndryshimit të kriterëve shkencorë mbi të cilat bazohet ribotimi i katërt, por edhe i të dhënave të reja statistikore dhe gjuhësore që disponojnë autorët. Shumë pozitiv është fakti që literatura ku është bazuar hartimi i këtij zëri është gjithashtu e re dhe përfshin edhe autorë e revista shqiptare në gjuhën shqipe, çka dëshmon për gjë zhvillim dhe afirmim të shkencës shqiptare.

Ja literatura që shoqëron këtë zë: Bevington, G. L. [1974]: *Albanian phonology*. Wiesbaden. Çabej, E. [1975-1977]: *Studime Gjuhësore*. 5 vëllime. Prishtinë. Demiraj, B & A. Esposito [2006]: *Albanian*. Në Encyclopedia of language & linguistics. Ed. K. Brown et al., botimi i dytë, 14 vëllime. Amsterdam 2006. Vëllimi I: 155-157. Huld, M. E. [1983]: *Basic Albanian etymologies*. Columbus, OH.

Nën titullin *Gramatika historike* përmenden: Demiraj, S. [1986]: *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*. Tirana. Mann, S [1977]: *An Albanian historical grammar*. Hamburg. Nën titullin *Gramatika gjejmë*: Buchholz, O & W. Fiedler [1987]: *Albanische Grammatik*, Lajpcig. Camaj, M. [1984]: *Albanian grammar*. (Collaborated on and translated by L. Fox). Wiesbaden. Nën titullin *Fjalorë*: Buchholz, O. & W. Fiedler & G. Uhlisch [1999]: *Wörterbuch Albanisch-Deutsch*. Botimi i dhjetë. Mynih. Dharmo, A. & H. Bezhanj [1996]: *Deutsch-Albanisches Wörterbuch*. Dy vëllime. Wiesbaden. *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe* [1980]: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë. Tirana. Nën titullin *Revista* rreshtohen këto revista shqiptare dhe të

huaja: Gjurmime Albanologjike - Lidhja - Linguistique Balkanique - Studia Albanica - Studime Filologjike - Zeitschrift für Balkanologie - Zjarri.

Bie në sy që shqipja përdoret vetëm një herë për ilustrim te zëri “Isolierte Sprachen / Gjuhë të izoluar” (Bußmann 2008: 310). Zëra të tjerë që do të lidheshin me shqipen si ilirishtja, trakishtja, Lidhja Gjuhësore Ballkanike etj. mungojnë. Kjo përbën sipas mendimit tim një dobësi të këtij fjalori që duhet përmirësuar në të ardhmen.